

2022

RAPORTI VJETOR

INDEP

Studim politikash

PARIMET E RIMËKËMBJES SË GJELBER PËR KOSOVËN – MËSIMET NGA PAKOT PARAPRAKË DHE RRUGA PËR RIMËKËMBJE TË QËNDRUESHME



Emigrimet e popullsisë - një mundësi e pashfrytëzuar për zhvillim lokal në Kosovë



GAZI NATYROR SI OPSION PËR TRANZICION TË QËNDRUESHËM TË ENERJISË NË KOSOVË

Analizë Politikash



ANALIZË POLITIKASH

POLITIKAT E TAKSIMIT TË KARBONIT

RËNDËSIA, SFIDAT DHE MUNDËSITË PËR KOSOVËN

CO₂ TAKSA



Raport përmblidhës i monitorimit të zbatimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike të Qeverisë

shkatërrimi ekologjik

Koha të veprimjesh!



PAKO E RINGJALLJES EKONOMIKE (PRE) - VROJTIM I EFEKTEVE TË PRE NË EKONOMINË E KOSOVËS



PËRMBUSHJA E OBJEKTIVAVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NË KOSOVË

Perspektiva e Shoqërisë Civile



Analizë e draftit regullor për vet-konsumatorët me burime të ripërtëritshme



Ngritja e çmimeve të energjisë – masat për zbutjen e krizës energjetike

Analizë politikash



OZHQ-të përballë fushëveprimtarisë dhe misionit të komunave të Kosovës



RIMËKËMBJE, GJITHPËRFSHIRJE, QËNDRUESHMËRI

Buletini nr. 12 KORRIK 2022



TRANZICIONI I DREJTË I ENERJISË NË KOSOVË - SI TË PROJEKTOHET DHE SI TË ARRIHET?

07/2022



ANALIZË E EFEKTEVE EKONOMIKE TË PAKOS SË RINGJALLJES – NGA PREMTIMET POLITIKE NË MASA SHITËTORE



ZBATIMI I AGJENDËS SË GJELBER PËR KOSOVËN NJË VIT PAS SAMITIT TË SOFJES

Raport i progresit

06/2022



Zbatimi i Pakos së Ringjalljes Ekonomike të Qeverisë

RAPORT I MONITORIMIT

03/2022



PARAFJALË

Pas 10 vite pune, INDEP këtë vit ka vazhduar misionin për sigurimin e institucioneve transparente për qytetarët e Kosovës dhe promovimin e vlerave demokratike. Ne gjithashtu i kemi shtyrë përpara programet tona për qeverisje demokratike, zhvillim të qëndrueshëm dhe bashkëpunim rajonal.

Periodha e pandemisë kishte pasojat e saj negative edhe në fushën e shoqërisë civile, mirëpo dy vite pas saj, viti 2022 ka shënuar fillimin e një dekade të dytë për institutin INDEP, duke lënë mbrapa rreth 50 projekte të suksesshme të mbështetura nga 30 donatorë, si dhe mbi 200 publikime e 6 platforma të lansuara. Kjo faqe e re për INDEP ka filluar me një sërë projektesh e aktiviteteve që u japin zë problematikave me interes publik.

Instituti për politika zhvillimore vazhdon të jetë pika kyçe në rrugën drejt avancimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Gjatë këtij viti ne kemi rritur bashkëpunimin tonë me Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm, rezultat i të cilës kanë dalë projekte të suksesshme me komuna, hulumtime e analiza si dhe forume e konferenca kombëtare.

Jemi të lumtur të mbyllim vitin 2022 me faktin që puna jonë ka lënë gjurmë në proceset e politikë-bërjes dhe tranzicionit të gjelbër në Kosovë. Puna jonë do të ishte e pamundur pa mbështetjen e donatorëve, partnerëve, aktivistëve, bashkëpunëtorëve vendor dhe ndërkombëtarë si dhe institucioneve që na dhanë hapësirë për kontribut.

Sinqerisht,
Burim Ejupi, Drejtor Ekzekutiv i INDEP



PËRMBAJTJA

- 01** Për ne
- 02** Puna e INDEP
- 03** Programet
- 04** Qeverisja Demokratike
- 05** Zhvillimi i Qëndrueshëm
- 06** Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkombëtar
- 07** Donatorët dhe Mbështetësit

PËR NE

Themeluar në vitin 2011, INDEP ka punuar për më shumë se një dekadë për të ngritur transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike në Kosovë. INDEP ka në fokus të veçantë forcimin e qeverisjes demokratike dhe luan rolin e mbikëqyrësit të politikave publike, ku përmes analizave dhe hulumtimeve të fokusuara në politika zhvillimore, ofron zgjidhje strategjike për politikatat publike.

Misioni:

Për të fuqizuar dhe promovuar zhvillimin e qëndrueshëm socio-politik dhe ekonomik bazuar në parimet e demokracisë dhe vlerave demokratike, mundësive të barabarta, drejtësisë sociale dhe mjedisore dhe të drejtave të njeriut.

Vizioni:

Një shoqëri demokratike, e aftë dhe e gatshme të drejtojë një shtet funksional, të integruar në rajon dhe në bashkësinë ndërkombëtare

PUNA E INDEP

Publikime
15

Analiza
6

OP-ED
2

Buletine
7

Reagime
6

Fushata
2

Raporte
9

Infografika
69

Evente
15

Podkaste
5

Video
5

Platforma
2

Konsultime Publike
3

Paraqitje mediatike
279

PROGRAMET



Qeverisja Demokratike

Në programin e Qeverisjes Demokratike hulumtimi i politikave kombinohet me avokim të vendosur duke u fokusuar në parti politike funksionale, sigurimin e zgjedhjeve të pavarura e të drejta, fuqizimin sundimin të ligjit dhe përparimin e lirisë së mediave.



Zhvillimi i Qëndrueshëm

Programi i Zhvillimit të Qëndrueshëm e bën INDEP institutin e parë në rajon që promovon zhvillim ekonomik i cili avancon kushtet shoqërore dhe politike duke mbrojtur ambientin. Ky program fokusohet në projektet ekonomike dhe energjetike në Kosovë e rajon.



Bashkëpunimi Rajonal


Bashkëpunimi Rajonal është një parakusht për rrugën e vendeve të Ballkanit perëndimor për në Bashkimin European. INDEP synon që të promovojë dhe forcojë këtë bashkëpunim në fushat e sigurisë dhe integrimeve Euro Atlantike.

QEVERISJA DEMOKRATIKE

Ky program është një nga shtyllat kryesore të punës së INDEP, në kuadër të cilit implementohen projekte mbi mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurimin e proceseve transparente në institucione publike. Gjatë vitit 2022 INDEP në partnerite me UNDP ka filluar implementimin e projektit "Climate Promise Project - Growth through Green and Just Recovery from COVID19" që synon trajnimin e gazetarëve për gazetarinë investigative të gjelbër dhe avokimin për politika dhe praktika që promovojnë punën e gazetarëve në mbrojtjen e mjedisit dhe informimin e publikut.

PACT+

Me misionin për të siguruar një qasje ndërinstitucionale për mbrojtjen e konsumatorëve në treg, projekti PACT+ për vitin e tretë me radhë u ka ofruar asistencë praktike qytetarëve mbi të drejtat e tyre si konsumatorë. Projekti PACT+ gjithashtu i ka vënë theks të veçantë nevojës së amendamentimit të legjislacionit në fuqi në mënyrë që të përfshihen nivele substanciale të mbrojtjes së konsumatorëve.



CORR Watch

Sigurimi i proceseve të rekrutimit të bazuara në merita dhe transparencë brenda administratës, monitorimi i praktikave të prokurimit publik dhe menaxhimit të kontratave, monitorimi i procesit të dhënies së granteve dhe subvencioneve, monitorimi në fushën e dhënies së licencave, lejeve dhe tarifave, si dhe mbështetja e performancës konkrete dhe përmirësimi i qeverisë së Ndërmarrjeve Publike janë komponentat kryesore të projektit.

Konsultime Publike

Konsultimi	Numri i komenteve
Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit	2 të përgjithshme 7 specifike
Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030	3 të përgjithshme 9 specifike
Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022 - 2031	4 të përgjithshme 14 specifike

Si rezultat i pjesëmarrjes aktive të INDEP në konsultime drejtpërdrejt janë ndryshuar 14 politika publike

Pjesëmarrja në Komisione

Komisioni për
Ekonomi,
Industri,
Ndërmarrësi dhe
Tregti

Këshilli për
Zhvillim të
Qëndrueshëm

Grupi punues për
ekonomi qarkore

Forumi për
Transparence

Këshilli i
mbrojtjes së
konsumatorëve

Këshilli
Kombëtar për
Ndryshime
Klimatike

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Programi i Zhvillimi të Qëndrushëm ka një rëndësi të veçantë në përmbushjen e vizionit të institutit INDEP, pasi që konsiderojmë se mbi bazën e zhvillimit të qëndrueshëm ndërtohet e ardhmja e vendit. Në kuadër të këtij programi gjatë vitit 2022 janë realizuar projekte me fokus në avancimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, është zhvilluar platforma e përcjelljes së progresit të komunës së Drenasit në arritjen e OZhQ-ve, si dhe aktivitete avokues duke përfshirë Javën e Zhvillimit të Qëndrueshëm (KSDW) dhe Forumin për OZhQ-të. Zhvillimi i këtij programi mbështetet nga Rockefeller Brothers Fund.

Taksa në Karbon

Me synimin e promovimit të taksës së karbonit, nëpërmjet avokimit, rekomandimeve, infografikëve dhe punimeve kërkimore, INDEP ka ndikuar në përfshirjen e taksës së karbonit në draft Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës. Ky projekt në fokus ka pasur gjithashtu promovimin e tranzicionit të energjisë dhe përmirësimin e sektorit të energjisë në Kosovë, duke ngritur vetëdijen e qytetarëve për kursimin e energjisë.





Ura e OZhQ-ve


Objektivi kryesor i këtij projekti është të përfshijë OZHQ-të në kuadrin e politikave të rimëkëmbjes COVID-19 duke promovuar mekanizmat e lokalizimit, zbatimit dhe monitorimit në nivel lokal dhe krijimin e një ure komunikimi dhe mbështetjeje midis politikave të nivelit qendror dhe nismave lokale. Përmes punës kërkimore dhe avokuese, INDEP synon të informojë palët e interesit lidhur me iniciativën në përgjithësi, si dhe të ofrojë shembuj konkretë krahasues nga rajoni që do të përmirësonin qëndrimin ekonomik, social dhe mjedisor në Kosovë. Ngritja e kapaciteteve për zyrtarët komunalë për OZHQ-të dhe Punëtorja e Përbashkët ndërmjet Këshillit Kombëtar të SDG-ve dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës janë disa nga aktivitetet kryesore të këtij projekti.

Java e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë - KSDW

Java e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2022 është fokusuar ekskluzivisht në lehtësimin e një dialogu në lidhje me avancimin dhe mbështetjen e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Kjo u arrit duke organizuar një konferencë 3-ditore, ku institucionet kompetente (ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale) u mblodhën në një sallë të vetme për të diskutuar tema të qarta në 5 shtyllat e Axhendës së Gjelbër.



KSDW gjithashtu organizon aktivitete për publikun me qëllim të avancimit të statusit të qëndrueshmërisë në rajon dhe rritjen e ndërgjegjësimit të përgjithshëm për mbrojtjen e mjedisit.



Forumi i Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve

Në nëntor të vitit 2022 u organizua edicioni i dytë me radhë i Forumit të OZhQ-ve me temë: 'Koordinimi në mes të nivelit lokal dhe qendror të qeverisjes për zbatimin e Agjendës 2030'



Forumi ka shtjelluar dy panele diskutimi. Paneli i parë u zhvillua për temën "Mbështetja teknike, monitorimi dhe raportimi për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në nivel kombëtar", me përfaqësues nga Zyra për Planifikim Strategjik, Agjencisa e Statistikave të Kosovës dhe Zyra e Koordinatorës së OKB-së për Zhvillim



Në panelin e fundit së bashku me kryetarë të komunave nga Kosova dhe Shqipëria, dhe ekspertë u diskutua për temën 'Rëndësia dhe angazhimi i qeverisjes lokale për zbatim dhe monitorim të Agjendës 2030 dhe OZhQ-ve'.

BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR

Global Forum

Network Meeting

Takimi i Rrjetit të Forumit Global në shtator në Cape Town, solli shumë platforma ndërkombëtare me shumë palë, këshille dhe organe të ngjashme këshillimore për zhvillim të qëndrueshëm.



COP27 – bashkë për zbatim

Konferenca globale për ndryshime klimatike “COP27 – bashkë për zbatim” u organizua në Sharm-El Sheik të Egjiptit. Bashkë me takimin vjetor të Rrjetit Ndërkombëtar të Think Tank-eve të Tranzicionit të Energjisë (INETTT) kjo vizitë shërbeu për rrjetizim, për vendosje të Kosovës në hartën e COP dhe për avancimin e programit të INDEP për zhvillim të qëndrueshëm dhe bashkëpunim rajonal.

COP27
SHARM EL-SHEIKH
EGYPT 2022





Konventa III e Think Tank-ve Ballkanike

Konventa III e Think Tank-ve Ballkanike me temën “Përforcimi i bashkëpunimit në sfidat gjeopolitike”, u organizua në Ankara.

Grupi për Politika të Energjisë

Shkolla verore e Grupit për Politika të Energjisë është mbajtur në Bukuresht (Rumani), ku anëtari i ekipit tonë, Liron Gjocaj, kontribuoi në ligjeratat dhe diskutimet mbi transformimin e mençur të sektorit të energjisë.



Open World project on “Oversight Bodies”

Fokusi ishte në diskutimin e praktikave më të mira dhe rolet e duhura për çdo palë të interesuar në personelin dhe rekrutimin e personelit për agjencitë, në shkrimin e ligjeve dhe rregulloreve mbi funksionimin e organeve të shqyrtimit rregullator, në monitorimin dhe mbikëqyrjen, si dhe në marrjen e masave disiplinore.



Takimi Vjetor i BERZH dhe Forumi i Biznesit

Gjatë sesionit “Të drejtat e njeriut, trajtimi dhe qasja” në takimin e organizuar në Marakesh, shefi i llogaridhënies i BERZH-it në një bisedë me menaxhmentin e BERZH-it, Shoqërinë Civile dhe Zyrën e OKB-së për të Drejtat e Njeriut shpali se si të forcohen masat mbrojtëse të kujdesit të duhur, të drejtat e njeriut dhe transparenca, të përmirësohet qasja dhe të mundësohet trajtimi.

Bureau Européen des Unions de Consommateurs

Me Byronë Evropiane të Unioneve të Konsumatorëve kemi diskutuar mbi sukseset e projektit për mbrojtjen e konsumatorit në Kosovë dhe mundësitë e zhvillimit më tutje të kësaj komponente.



Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm në Gjermani

Agjenda 2030 dhe përmbushja e hovshme e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ-ve) ishin fokusi kryesor i këtij takimi, por konkretisht u diskutua mbi mundësinë dhe nevojën për monitorim dhe raportin konsistent mbi OZhQ-të, si nga nivelet qendrore dhe atyre lokale në Kosovë.



European Movement Albania

Në bashkëbisedim me EMA u shkëmbyen përvojat në fushën e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve, sfidat dhe mundësitë për avancim të pozitës së konsumatorëve në Kosovë dhe Shqipëri.

Forumi i Shoqërisë Civile dhe Think Tank 2022

Konferenca e mbajtur në Berlin synon të sigurojë një platformë për shkëmbimin dhe rrjetëzimin e praktikave më të mira midis OSHC-ve nga rajoni dhe BE-ja dhe të fuqizojë nismat dhe idetë e shoqërisë civile ndër-rajonale dhe transnacionale.



Konferenca e financimit të energjisë IEEFA 2022

Konferenca IEEFA mbledhi së bashku ekspertë nga e gjithë bota për të eksploruar dinamikën e tregut të energjisë dhe për të ndarë strategjitë për përshpejtimin e tranzicionit global të energjisë.



Konferenca VI e Parqeve Dinaride

Objektivi kryesor i Konferencës ishte të forcoj bashkëpunimin rajonal, të përmirësoj koordinimin për ruajtjen e biodiversitetit në Ballkanin Perëndimor dhe të identifikonte sesi aktorë të ndryshëm mund të kontribuojnë dhe përmirësojnë ruajtjen e natyrës përmes zbatimit të Axfordës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor.

FJALË PËRMBYLLËSE

INDEP do të vazhdojë të shtyjë më tej programet e veta kryesore përmes avokimit dhe kërimit gjatë kësaj dekade. Kjo është koha për veprimin ndaj klimës, përmbushjes së objektivave për zhvillim të qëndrueshëm dhe fuqizimin e qeverisjes së mirë që së bashku lehtësojnë rrugën drejt integritit evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

DONATORËT DHE MBËSHTETËSIT



Funded by
the European Union



Implemented by



British Embassy
Pristina



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERËCKOG NARODA

Agora
Energiewende

